AVOKATI I POPULLIT

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni për organet e administratës qëndrore, të pushtetit vendor dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Telefax: 355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K 3/R.5-23 **Prot.**
Nr. Dok. 202502529/23

Tiranë 19/5 **/2026**

Lënda: *Rekomandim për përshpejtimin e përfundimit të procedurës administrative për kompensimin e pasurisë së paluajtshme të njohur në pronësi me të drejtë kompensimi sipas vendimit nr. 101, datë 08.02.2002, të dhënë nga ish-Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve, pranë Prefekturës së Qarkut, Fier.*

Drejtuar: **Agjencisë së Trajtimit të Pronave,**
Drejtoria e Kompensimit
Adresa: Rruga "Muhamet Gjollesha", Nr. 54

TIRANË

I nderuar z. Drejtor i Përgjithshëm!

Institucioni i Avokatit të Popullit në përmbushje të mandatit kushtetues dhe ligjor për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit, si dhe në funksion të **garantimit të tyre,** në bazë të nenit 13 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 "*Për Avokatin e Popullit*", të ndryshuar, ka marrë në administrim ankesën e shtetasit Ridvan Resuli, në të cilën prezantohet çështja e shkeljes/cenimit të parimit për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor si rrjedhojë e mospërfundimit të veprimtarisë administrative për kompensimin e pasurisë së paluajtshme, të njohur në pronësi me të drejtë kompensimi me vendimin nr. 101, datë 08.02.2002, të ish-Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve (*KKKP*), pranë Prefekturës së Qarkut, Fier, në dispozitivin e të cilit është vendosur:

"1. T'i njohë pronën ish-pronarit Ibrahim Resuli mbi një sipërfaqe toke bujqësore prej 650 dy.
2. T'i njohë të drejtën e kompensimit trashëgimtarëve të radhës së parë që janë: Fatbardha Resuli për 162.5000 m2, Ingrid Derri (Resuli) për 162.500 m2, Edvin Resuli për 162.500 m2, Ridvan Resuli për 162.500 m2, pra për 650 dy.
3. Bazuar në klasifikimin e fshatit të bërë në zbatim të pikës 4 të VKM-së nr. 703, datë 18.12.1995 nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Ushqimit të Rrethit, Fier, dhe në nenin 4 të ligjit nr. 7836, datë 22.06.1994, të bëj kompensimin e ish-pronarëve (trashëgimtarëve) të pikës 1 të këtij vendimi në vlerën si më poshtë:
Sip 150.000 m2 x 28 l/m2 = 4.200.000 lekë

Sip 500.000 m2 x 01 x 31 l/m2 = 1.550.000 lekë
Shuma = 5.750.000 lekë.
Ky vendim u përgatit në tre kopje.
Ngarkohen organet financiare për zbatimin e këtij vendimi.
Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 30 ditëve nga data e njoftimit në Gjykatën e Rrethit, Fier".

Në ankesën drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit, z. Resuli, shprehet, midis të tjerave, se, më datë 20.12.2023, i ka kërkuar Agjencisë së Trajtimit të Pronave *(ATP)*, me aplikimin me numër referencë ATP-2024-2539620-YU, kryerjen e veprimtarisë administrative për ekzekutimin e vendimit të lartpërmendur për kompensimin e pasurisë të njohur në pronësi. Në përgjigje të kërkesës/aplikimit, ATP-ja, me shkresën nr. 708/6 prot, datë 19.02.2025, ka bërë të ditur ankuesit, se:

"Pranë Sektorit të Kompensimit Financiar/Fizik dhe me kërkesë të veçantë për qarqet Fier, Vlorë, Elbasan, Durrës, Gjirokastër dhe Korçë, ndodhet e administruar kërkesa me nr. 708 prot, datë 02.12.2016, me objekt: "Ekzekutimin e vlerësimit financiar, në masën 20%, të pronës së njohur për kompensim me vendimin nr. 101, datë 08.02.2002, ish-KKKP Qarku Fier, dhënë në emër të subjektit të shpronësuar Ibrahim Resuli.
Gjatë procesit të verifikimit të kërkesës tuaj për kompensim, është konstatuar se vendimi nr. 101, datë 08.02.2002, i ish-KKKP, Qarku Fier, dhënë në emër të subjektit të shpronësuar Ibrahim Resuli, krijon mbivendosje me vendimin nr. 77, datë 07.09.1999, ish-KKKP, Qarku Fier, dhënë në emër të subjektit të shpronësuar Vasil Dashi, për një sipërfaqe prej 130.000 m2 (hartat bashkëlidhur).
...
Gjithashtu, gjatë shqyrtimit administrativ të kërkesës tuaj për kompensim, është konstatuar se sipërfaqja e konturuar në hartat e vendimit është 125 dynym më e vogël sesa sipërfaqja për të cilën është shprehur dispozitivi i vendimit.
Në këto kushte ju orjentojmë t'i drejtoheni gjykatës kompetente për zgjidhjen e problematikës së konstatuar".

Më tej, në ankesë, z. Resuli, shprehet, se:

"... ATP, nëpërmjet interpretimit të gabuar të legjislacionit në fuqi dhe orientimit të padrejtë e të pabazuar në lidhje me kërkesën tonë drejtuar atij institucioni, ka cenuar haptazi të drejtën tonë të përfitimit të vlerës monetare të kompensimit duke na krijuar pengesa dhe vonesa të pajustifikuara".
...
Në lidhje me këto pasaktësi dhe justifikime, sqarojmë si më poshtë:

Kërkesa jonë për kompensim financiar me kërkesë të veçantë e datës 02.12.2016, e përsëritur disa herë për kompensim në masën 40% të vlerës totale dhe jo 20% sipas citimit tuaj.

Pretendimi ... për mbivendosje të pronës tonë mbi pronën e dhënë më parë një subjekti tjetër për kompensim financiar, po sipas të njëjtit ligj nr. 7699, datë 21.04.1993 "Për kompensimin në vlerë të ish-pronarëve të tokës", është i pasaktë për arsye, se: ...."

Përsa pretenduar prej ankuesit, pranimi për shqyrtim i çështjes është kryer në kushtet e dyshimit për shkeljen e së drejtës të pronësisë apo parimit për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor,

si rrjedhojë e mospërfundimit në afatin ligjor të procedimit administrativ, lidhur me kompesimin e ankuesit, etj, sikurse vendosur nga ish-KKKP, pranë Prefekturës së Qarkut, Fier.

Në këto kushte, bazuar në nenin 63, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku parashikohet se: "*Organet dhe funksionarët publik janë të detyruar t'i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij*", si dhe neni 19, pika "b", të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "*Për Avokatin e Popullit*", të ndryshuar, sipas të cilit: "*Avokati i Popullit ka të drejtë të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin*", Institucioni ynë me anë të shkresës nr. K3/R5-2 prot., datë 01.04.2025, i ka kërkuar ATP-së, informacion dhe shpjegime, lidhur me:

- Vënien në dispozicion të kopjes së kërkesës për kompensim nr. 708, datë 02.12.2016, të kryer prej ankuesit, etj, si dhe përshëritjes së saj, për pasurinë e njohur në pronësi me të drejtë kompensimi sipas vendimit nr. 101, datë 08.02.2002, të ish-KKKP ish-Pronarëve, pranë Prefekturës së Qarkut, Fier;

- Informacion nëse bashkëlidhur vendimit nr. 101, datë 08.02.2002, të ish-KKKP, pranë Prefekturës së Qarkut, Fier, ka material hartografik që përcakton vendndodhjen dhe konfiguracionin e pasurisë të njohur në pronësi me të drejtë kompesimi. Nëse po, vënien në dispozicion të kopjes së këtij materiali hartografik që i bashkëlidhet vendimit nr. 101, datë 08.02.2002, të ish-KKKP, pranë Prefekturës së Qarkut, Fier, në ditën e dhënies së tij;

- Nëse disponohet material hartografik për pronën në fjalë, të njohur në pronësi me të drejtë kompensimi, pyesim: Kur është përgatitur ky material/dokumentacion? Vënien në dispozicion të kopjes së tij të përgatitur nga subjekti përgjegjës;

- Vënien në dispozicion të materialeve hartografik për pasuritë e njohura në pronësi me të drejtë kompensimi sipas vendimit nr. 101, datë 08.02.2002, të ish-KKKP, pranë Prefekturës së Qarkut, Fier, dhe nr. 77, datë 07.09.1999, të ish-KKKP, Lushnje, për të cilat ju shpreheni në Tuajën nr. 708/6 prot, datë 19.02.2025, se krijonë pjesërisht mbivendosje;

- Cila është vendodhja e pasurisë (fshati) të njohur në pronësi ankuesit, etj, me të drejtë kompensimi sipas vendimit nr. 101, datë 08.02.2002, të ish-KKKP, pranë Prefekturës së Qarkut, Fier, si dhe, cila është zona kadastrale në të cilën ndodhet/shtrihet kjo pronë;

- Cila është vendndodhja e pasurisë (fshati) të njohur në pronësi subjektit të shpronësuar Vasil Dashi, me të drejtë kompensimi sipas vendimit nr. 77, datë 07.09.1999, të ish-KKKP, Lushnje, si dhe, cila është zona kadastrale në të cilën ndodhet/shtrihet kjo pronë, për të cilën ju referoni në shkresën nr. 708/6 prot, datë 19.02.2025, drejtuar ankuesit Ridvan Resuli?

- A është nxjerrë deri më sot vendim për pezullimin e procedurave administrative për kompensimin e pasurisë të njohur në pronësi sipas vendimit nr. 101, datë 08.02.2002, të ish-KKKP, pranë Prefekturës së Qarkut, Fier?

- Fazën në të cilën ndodhet procesi i ekzekutimit prej ATP-së i vendimit nr. 101, datë 08.02.2002, të dhënë prej ish-KKKP, pranë Prefekturës së Qarkut, Fier;

- Vënien në dispozicion të dokumentacionit të mundshëm të nxjerrë/administruar në procesin e ekzekutimit deri më sot të vendimit nr. 101, datë 08.02.2002, të ish-KKKP, pranë Prefekturës së Qarkut, Fier;

- Çdo informacion tjetër që ka lidhje me çështjen e paraqitur.

Në përgjigje të kërkesës, ATP-ja me shkresën nr. 2042/1 prot, datë 16.04.2025, drejtuar Avokatit të Popullit, bën me dije, midis të tjerave, se:

"Pranë Sektorit të Kompensimit Financiar/Fizik dhe me Kërkesë të Veçantë për Qarqet, Fier, Vlorë, Elbasan, Durrës, Gjirokastër dhe Korçë, ndodhet e administruar kërkesa me nr. 708 prot, datë 02.12.2016, me objekt: "Ekzekutimin e vlerësimit financiar në masën 20% të pronës së njohur për kompensim me vendimin nr. 101, datë 08.02.2002, ish-KKKP Qarku, Fier, dhënë në emër të subjektit të shpronësuar Ibrahim Resuli".
Gjatë procesit të verifikimit të kërkesës për kompensim është konstatuar se vendimi nr. 101, datë 08.02.2002, i ish-KKKP, pranë Prefekturës së Qarkut, Fier, dhënë në emër të subjektit të shpronësuar Ibrahim Resuli, krijon mbivendosje me vendimin nr. 77, datë 07.09.1999, të ish-KKKP, pranë Këshillit të Rrethit, Lushnje, dhënë në emër të subjektit të shpronësuar Vasil Dashi për një sipërfaqe prej 130.000 m2 (hartat bashkëlidhur).
Referuar dokumentacionit hartografik, zona kadastrale në të cilën ndodhet sipërfaqja e pronës të njohur për kompensim me vendimin nr. 101, datë 08.02.2002, ish-KKKP, Qarku, Fier, dhënë në emër të subjektit të shpronësuar Ibrahim Resuli, pozicionohet në tre zona kadastrale, konkretisht: ZK 2286 (Fshati Krutje e Poshtme), ZK 3936 (Fshati Zhymë) dhe ZK 1197 (Fshati Bishqethëm), Lushnje.
Referuar dokumentacionit hartografik, zona kadastrale në të cilën ndodhet sipërfaqja e pronës të njohur për kompensim me vendimin nr.77, datë 07.09.1999, ish-KKKP Këshilli i Rrethit, Lushnje, dhënë në emër të subjektit të shpronësuar Vasil Dashi, e cila krijon mbivendosje me vendimin nr. 101, datë 08.02.2002, ish-KKKP, Qarku, Fier, në emër të subjektit të shpronësuar Ibrahim Resuli, është ZK 2286, Krutje e Poshtme, Lushnje.
...
Sa më sipër, ATP-ja nuk është institucioni kompetent për zgjidhjen e rasteve të tilla.
Gjithashtu, gjatë shqyrtimit administrativ të kërkesës për kompensim, është konstatuar se, sipërfaqja e konturuar në hartat e vendimit nr. 101, datë 08.02.2002, ish_KKKP, Qarku, Fier, është 125 dynym më e vogël sesa sipërfaqja për të cilën është shprehur dispozitivi i vendimit".

Me rastin e administrimit të informacionit si më sipër cituar, në vijim të kërkesës së institucionit të Avokatit të Popullit, nr. K3/R5-6 prot, datë 30.04.2025[1], lidhur me planvendosjet e pronës, ATP-ja, me shkresën nr. 2621/1 prot, datë 3.05.2025, bën me dije, midis të tjerave, se:

---

[1] Me anë të kësaj shkrese i është kërkuar ATP-së si vijon:
-Informacion se cili organ apo subjekt ka përgatitur planvendosjen/planimetrinë e pronës të njohur në pronësi me të drejtë kompensimi subjektit Ibrahim Resuli sipas vendimit nr. 101, datë 08.02.2002, të ish-KKKP, Qarku, Fier. A ndodhet bashkëlidhur vendimit nr. 101, datë 08.02.2002, të ish-KKKP, Qarku, Fier, planvendosja/planimetria që ju referoni si pjesë përbërëse e tij? Nëse po, kërkojmë vënien në dispozicion të kopjes së vendimit nr. 101, datë 08.02.2002, të ish-KKKP, pranë Prefekturës së Qarkut, Fier, së bashku me planvendosjen/planimetrinë që i bashkëlidhet këtij vendimi. Vendimi nr. 101, datë 08.02.2002, i ish-KKKP, pranë Prefekturës së Qarkut, Fier, nuk përcakton ekzistencën e planvendosjes/planimetrisë bashkëlidhur tij. Atëhere, si shpjegohet ekzistenca e një materiali hartografik për pronën e njohur me të drejtë kompensimi në dosjen tuaj? Si është administruar nga ATP-ja ky material hartografik?

"Sa i takon pikës së parë të kërkesës tuaj, ju sqarojmë se, vendimi nr. 101, datë 08.02.2002, ish-KKKP, pranë Prefekturës së Qarkut, Fier, dhënë në emër të subjektit të shpronësuar Ibrahim Resuli, është marrë në zbatim të ligjit nr. 7699/1993 dhe VKM-së nr. 560, datë 16.10.1995 "Për kompensimin në vlerë të ish-pronarëve të tokës bujqësore", i ndryshuar, dhe nuk ka qenë detyrim ligjor përmendja në vendim e hartës bashkëlidhur.
Gjithashtu, në referim të pikës 5/a të VKM-së nr. 560, datë 16.10.1995 "Për kompensimin në vlerë të ish-pronarëve të tokës bujqësore", i ndryshuar, përcaktohej se: "Ish-pronarët ose trashëgimtarët e tyre ligjor që pretendojnë kompensimin në vlerë të tokës bujqësore në zbatim të nenit 14 të ligjit, duhet të paraqesin, aktin e pronësisë nga kadastra ose hipoteka. Në mungesë të tyre, vendimin e gjykatës për vërtetimin e pronësisë ... ".
Në rastin konkret, subjekti ka paraqitur vërtetimin e pronësisë nr. 185/3, datë 15.08.1994, lëshuar nga Arkivi Shtetëror i Lushnjes, sipas të cilit ish-pronari Ibrahim Resuli, ka pasur në pronësi 225 dynym tokë në Fshatin Zhymë, dhe 1000 dynym tokë në Fshatin Bishqethëm dhe Krutje e Poshtme.
Referuar dokumentacionit hartografik i cili është në emër të subjektit të shpronësuar Ibrahim Resuli dhe mban vulën e ish-KKKP të Prefekturës së Qarkut, Fier, sipërfaqja e pronës së njohur për kompensim me vendimin nr. 101, datë 08.02.2002, nga ish-KKKP, pranë Prefekturës së Qarkut, Fier, dhënë në emër të subjektit të shpronësuar Ibrahim Resuli, pozicionohet në tre zona kadastrale, konkretisht ZK 2286 (Fshati Krutje e Poshtme), ZK 3936 (Fshati Zhymë) dhe ZK 1197 (Fshati Bishqethëm), Lushnje.
Po ashtu, në kërkesën e paraqitur nga vetë subjekti kërkues Ridvan Resuli, pranë ish-KKKP, pranë Këshillit të Rrethit, Lushnje, me objekt: "... pajisjen me vendim përkatës për kompensim të sipërfaqes së papërfituar nga komisioni i ndarjes së tokës", është cituar skica bashkë me relacionin përkatës. Në inventarin e brendshëm të dosjes nr. 415/1, datë 09.12.1996, të vendimit nr. 101, datë 08.02.2002, të ish-KKKP, pranë Prefekturës së Qarkut, Fier, dhënë në emër të subjektit të shpronësuar Ibrahim Resuli, po ashtu janë cituar dy planvendosje të pronës.
Sa i takon pikës së dytë të kërkesës tuaj, po ju shpjegojmë se pozicioni i pronës, konstatimi i mbivendosjes dhe problematikave të tjera, është bërë në bazë të planvendosjeve të cilat ua kemi përcjellë me shkresën nr. 2042 prot, datë 16.04.2025.
Sa i takon pikës së tretë, konstatimi i mbivendosjeve të të gjitha subjekteve të cilët janë trajtuar me vendime nga ish-KKKP...bëhet nga hartat e vendimeve përkatëse të pozicionuara në sistemin Ëeb-GIS me të cilin ATP punon".

Në vijim të procedurës hetimore, është kërkuar me shkresën nr. K3/R5-8 prot, datë 26.05.2025, ATP-së, informacion lidhur me:

- Cili është subjekti i autorizuar që ka hartuar planvendosjet e dërguara nga ana juaj në përgjigjen e sipërcituar, përkatësisht për vendimin nr. 101, datë 08.02.2002 dhe nr. 77, datë 07.09.1999 të ish-KKKP, pranë Prefekturës së Qarkut, Fier? Nga cili organ janë miratuar këto planvendosje si dokumente të vlefshme teknike për procedurën administrative përkatëse?

- Referuar aktit mbi bazë të të cilit është dhënë vendimi nr. 101, datë 08.02.2002, të ish-KKKP, pranë Preferkuturës së Qarkut, Fier, rezulton se sipërfaqja prej 650 dynym e njohur në pronësi me të drejtë kompesimi ndodhet në Fshatin Zhymë dhe Bishqethëm, Lushnje. Pyesim: Cili është materiali hartografik bashkëlidhur vendimit në fjalë, që provon se sipërfaqja 650 dynym, e njohur në pronësi me të drejtë kompensimi, shtrihet dhe në Fshatin Krutje e Poshtme, Lushnje?

- Këto plan-vendosje të dërguara nga ana juaj, a kanë qenë pjesë e dokumentacionit tekniko-ligjor të administruar respektivisht në dosjet për të cilat ish-KKKP, pranë Prefekturës së Qarkut, Fier dhe Këshillit të Rrethit (KRR), Lushnje, kanë nxjerrë vendimet nr. 101, datë 08.02.2002 dhe nr. 77, datë 07.09.1999?

  Përse në këto planvendosje nuk ka element të nevojshëm të cilët vërtetojnë kohën e hartimit të tyre dhe paraqitjes si dokument teknik në dosjen përkatëse për vendimmarrjen e pritshme të ish-KKKP, pranë Preferkuturës së Qarkut, Fier?

Në përgjigje të informacionit të kërkuar, ATP, me shkresën nr. 3077/1 prot, datë 09.06.2025, bën me dije, midis të tjerave, se:

"Në referim të pikës 5/1/b të VKM-së nr. 560, datë 16.10.1995 "Për kompensimin në vlerë të ish-pronarëve të tokës bujqësore", i ndryshuar, përcaktohej se, pretendentët ish-pronarë të kullotave, livadheve, tokave pyjore e pyjeve, në zbatim të neneve 7/1, 7/2 dhe 7/3 të ligjit nr. 7699/1993, duhet të hapin dosje të veçantë, e cila krahas dokumenteve të përcaktuara në shkronjat a, b, c dhe d, të pikës 5, të përmbajë edhe këto dokumente:

-Planvendosja me kufizimet sipas dokumentacionit të pronësisë nga kadastra.
...
Në kërkesën e paraqitur nga vetë subjekti kërkues Ridvan Resuli, pranë ish-KKKP, pranë Këshillit të Rrethit, Lushnje, me objekt: "... paisjen me vendim përkatës për kompensim të sipërfaqes së papërfituar nga komisioni i ndarjes së tokës", është cituar skica bashkë me relacionin përkatës. Në inventarin e brendshëm të dosjes nr. 415/1, datë 09.12.1996, të vendimit nr. 101, datë 08.02.2002, të ish-KKKP, pranë Prefekturës së Qarkut, Fier, dhënë në emër të subjektit të shpronësuar Ibrahim Resuli, po ashtu, janë të cituara dy planvendosje të pronës.
Gjithashtu, në referim të pikës 4/b të VKM-së nr. 560, datë 16.10.1995 "Për kompensimin në vlerë të ish-pronarëve të tokës bujqësore", i ndryshuar, përcaktohej se: "Komisionet kontrollojnë vërtetësinë e dokumentacionit që paraqesin kërkuesit dhe e ballafaqojnë me dokumentacionin teknik të zyrës së kadastrës për sasinë e sipërfaqes dhe masën e kompensimit që u takon.
Sa më sipër, dokumentacioni hartografik, i administruar në dosjen nr. 415/1, datë 09.12.1996, është në emër të subjektit të shpronësuar Ibrahim Resuli dhe mban vulën e njomë të ish-KKKP pranë Prefekturës së Qarkut, Fier. ...".

Bazuar në informacionin e dhënë prej ATP-së, institucioni i AP-së ka vijuar kërkimin e informacionit me shkresën nr. K3/R5-13 prot, datë 17.07.2025, lidhur me:

- Vënien në dispozicion të kopjes së plotë të vendimit nr. 77, datë 07.09.1999 të KKKP, pranë Prefekturës së Qarkut, Fier;
- Kopjes së vendimit gjyqësor nr. 5931, datë 09.06.1998, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Lushnje, së bashku me materialin hartografik, sipas të cilit është vendosur për *"Vërtetimin e faktit"* për pasurinë e njohur në pronësi me të drejtë kompensimi me vendimin nr. 77, datë 07.09.1999, prej KKKP, pranë Këshillit të Rrethit, Lushnje;
- Relacionin shoqërues dhe skicat e përpiluara dhe dorëzuara nga Kadastra, Zyra e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës (*ZAMT*) pranë Këshillit të Rrethit, Lushnje, në ish-KKKP pranë Prefekturës së Qarkut, Fier, me rastin e dhënies së vendimit nr. 101, datë 08.02.2002;

- Relacionin shoqërues dhe skicat e përpiluara dhe dorëzuara nga Kadastra (ZAMT) pranë Këshillit të Rrethit, Lushnje, në ish-KKKP, me rastin e dhënies së vendimit nr. 77, datë 07.09.1999.

Në përgjigje të kërkesës, ATP-ja, më shkresën nr. 4058/1 prot, datë 29.07.2025, përsërit të njëjtin qëndrim të shprehur në shkresën nr. 3077/1 prot, datë 09.06.2025, drejtuar AP-së.

Në këtë situatë, i jemi ridrejtuar sërish ATP-së me shkresën nr. K3/R5-17 prot, datë 12.08.2025, për dhënien e informacionit, lidhur me:

- Informacion se sa është sipërfaqja e tokës bujqësore për Fshatin Krutje e Poshtme, Lushnje, ZK 2286, të shqyrtuara dhe pjesë e vendimit nr. 101, datë 08.02.2002, të dhënë nga ish-KKKP, pranë Preferkuturës së Qarkut, Fier, bazuar në dokumentacion ligjor Vërtetim nr. 183/3, datë 15.08.1994, si dhe dokumentin ligjor, Deklarata nr. 192, datë 26.10.1945 e Arkivës, Lushnje?
- Vënien në dispozicion të genplanit të tokës bujqësore në emër të Ibrahim Resuli, konkretisht për Fshatin Krutje e Poshtme, mbi të cilat është llogaritur çmimi, vlera e tokës bujqësore të kompensuar financiarisht me vendimin nr. 101, datë 08.02.2002;

- Vënien në dispozicion të relacionit dhe genplanit hartografik, i cili i ka shërbyer specialistëve të ATP-së për të konkluduar që sipërfaqja e pronës së njohur me vendimin nr. 101, datë 08.02.2002, në sipërfaqe totale 650 dy, ka mbivendosje dhe pozicionohet në tre zona kadastrale, ZK 2286, ZK 3936 dhe ZK 1197;

Për këtë kërkesë, ATP-ja me shkresën nr. 4460/1 prot, datë 22.08.2025, drejtuar institucionit tonë, shprehet se është mundësuar dhënia e gjithë informacionit dhe dokumentacionit që disponohet për këtë çështje.

Në vijim të procedurës hetimore, kemi kërkuar me anë të shkresës nr. K3/R5-20 prot, datë 09.10.2025[2], informacion të mëtejshëm. Në përgjigje të kërkesës, ATP-ja me shkresën nr. 53208/1 prot, datë 30.10.2025, drejtuar institucionit tonë, shprehet se:
"Sa i takon pikës së parë të kërkesës tuaj, sqarojmë se, në referim të pikës 20, Kreu III, VKM nr. 223, datë 23.03.2016, për "....", përcaktohet se, "Në rastet kur ATP-ja vlerëson se për ekzekutimin e vendimit përfundimtar është i nevojshëm një verifikim administrativ, atëhere ajo

[2] Me anë të kësaj shkrese drejtuar ATP-së për informacion është kërkuar:
- Prezantimin e shkakut/arsyes të mostrajtimit të kërkesës numër reference ATP-2024-2539620-YU, datë 20.12.2023, të subjektit ankues, sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 223, datë 23.03.2016 *"Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin dhe ekzekutimin e vendimeve përfundimtare të kompensimit të pronës dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave"*(ndryshuar me VKM-në nr. 685, datë 28.9.2016; nr. 766, datë 20.12.2017, nr. 1114, datë 24.12.2020, vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 4, datë 15.2.2021 dhe nr. 313, datë 24.5.2023) pika 5, pika 6, Pika 21/1 e kreut III, të VKM-së nr. 223, datë 23.03.2016, Pika 40/1 e kreut VII.
- Informim nëse ATP-ja ka pasqyruar e bërë publik në regjistrin e vendimeve përfundimtare mangësi në dokumentacionin e depozituar prej ankuesit. Nëse po, kur është kryer publikimi/njoftimi i tyre dhe në cilin akt ligjor apo nënligjor (neni, paragrafi) mbështetet qëndrimi juaj për mosprocedim në ekzekutimin e vendimit përfundimtar të kompensimit të pronës në referim të mangësisë të pretenduar prej ATP-së?
- Cilat janë numrat e parcelave në të cilat shtrihet pasuria e njohur me të drejtë kompensimi ankuesit, etj, sipas vendimit nr. 101, datë 08.02.2002, të ish-Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve, pranë Prefekturës së Qarkut, Fier?

kryen procedurën verifikuese, sipas procedurave të përcaktuara në Kodin e Procedurës Administrative".

Gjithashtu, në referim të pikës 11, Kreu II, VKM-së nr. 223/2016, i ndryshuar, përcaktohet se: "Në rastin kur konstatohen të meta nga ATP-ja, gjykata ose subjekti lidhur me informacionin e publikuar, i cili është i nevojshëm për vlerësimin financiar të vendimeve përfundimtare të kompensimit, ATP-ja përditëson regjistrin e vendimeve me të dhënat e sakta".
Po ashtu, ligji nr. 44/2015, neni 112, "Korrigjimi i gabimeve materiale në aktin administrativ", i cili përcakton "Organi publik, në çdo kohë, kryesisht apo, me kërkesë, mund të korrigjojë gabimet e shkrimit, gabimet në përllogaritje dhe pasaktësi të tjera të dukshme, në një akt administrativ".
Në zbatim të sa më sipër, ATP-ja me shkresën nr. 708/6 prot, datë 19.02.2025, ka njoftuar subjektin kërkues për problematikën e konstatuar gjatë procesit të verifikimit të kërkesës për ekzekutimin e vlerësimit financiar, të pronës së njohur për kompesim me vendimin nr. 101, datë 08.02.2002, ish-KKKP, Qarku, Fier, dhënë në emër të subjektit të shpronësuar Ibrahim Resuli dhe grupi i punës ka kryer ndryshimet në sistemin Ëeb-GIS. Në vijim ATP do të përditësojë të dhënat e publikuara në regjistrin elektronik duke shtuar problematikat e konstatuara.
Sa i takon pikës së dytë të kërkesës tuaj, referuar dokumentacionit hartografik, sipërfaqja e pronës së njohur për kompensim me vendimin nr. 101, datë 08.02.200, të ish-KKKP, Qarku Fier, dhënë në emër të subjektit të shpronësuar Ibrahim Resuli, pozicionohet në tre zona kadastrale, konkretisht, ZK 2286 (Fshati Krutje e Poshtme), ZK 3936 (Fshati Zhymë) dhe ZK 1197 (Fshati Bishqethëm), Lushnje.
Po ju citojmë numrat e pasurive të cilët janë trajtuar me të drejtë kompensimi me vendimin e mësipërm sipas zonave kadastrale.
Zona kadastrale nr. 1197, numrat e pasurisë: 101/1, 101/2, 101/3, 101/4, 101/5, 101/20, 556, 137/7.
Zona kadastrale nr. 2286, numrat e pasurisë: 138, etj.
Zona kadastrale nr. 3936, nuk është në sistem dhe jemi në pamundësi të dhënies së informacionit".

Sa më sipër, gjatë hetimit administrativ, është provuar si vijon:

- Ankuesi Ridvan Resuli ka paraqitur kërkesën/aplikimin nr. 708 prot, datë 02.12.2016, për **ekzekutimin e vlerësimit financiar** në masën 20% të pronës së njohur për kompensim me **vendimin nr.** 101, datë 08.02.2002, **të ish-KKKP,** pranë Prefekturës së Qarkut, Fier. Kërkesa për ndryshimin e masës së kompensimit nga 20% në 40% është kryer prej ankuesit me anë të kërkesës datë 20.12.2023, drejtuar ATP-së;
- **ATP-ja justifikon mosekzekutimin e vendimit nr.** 101, datë 08.02.2002, **të ish-KKKP,** pranë Prefekturës së Qarkut, Fier, **me pretendimin e mbivendosjes** së pjesshme, në një sipërfaqe prej 130.000 m2, ndërmjet sipërfaqes të njohur në pronësi me të drejtë kompensimi me vendimin nr. 101, datë 08.02.2002, të ndjerit Ibrahim Resuli dhe sipërfaqes të njohur në pronësi me të drejtë kompensimi sipas vendimit nr. 77, datë 07.09.1999, subjektit Vasil Dashi;
- **ATP-ja referon mospërputhje/diferencë në masën 125 dynym midis sipërfaqes** së tokës të njohur në pronësi me të drejtë kompensimi sipas vendimit nr. 101, datë 08.02.2002, dhe sipërfaqes së saj të pasqyruar në hartën referuese të ATP-së;
- ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar të vendimit nr. 101, datë 08.02.2002, si dhe publikuar rregullisht atë në regjistrin e publikimeve pa evidentuar asnjë parregullsi;
- ATP nuk ka marrë vendim formal për **pezullim të procedurës, si dhe** nuk ka vijuar me ekzekutimin për shkak të konstatimeve të sipërpërmendura;

- ATP-ja në procesin e shqyrtimit të kërkesës/aplikimit nr. 708 prot, datë 02.12.2016, të ankuesit, bazon qëndrimin mbi aktin nënligjor, VKM nr. 560, datë 16.10.1995 *"Për kompensimin në vlerë të ish-pronarëve të tokës bujqësore"*, të shfuqizuar me VKM nr. 223, datë 23.03.2016 *"Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin dhe ekzekutimin e vendimeve përfundimtare të kompensimit të pronës dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave"*, i ndryshuar *(VKM nr. 223/2016)*, përsa i përket detyrimit të kërkuesit për dorëzimin e *"Planvendosjes me kufizimet sipas dokumentacionit të pronësisë nga kadastra"*.

Baza ligjore për trajtimin e kësaj çështje, sikurse ka rezultuar edhe gjatë hetimit administrativ, janë aktet ligjor dhe nëligjor në fuqi, si vijon:

- Ligji nr. 133/2015, *"Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave"*, i ndryshuar;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 223, datë 23.03.2016, i ndryshuar, *"Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin dhe ekzekutimin e vendimeve përfundimtare të kompensimit të pronës..."*, i ndryshuar;
- Ligji nr. 44/2015, *"Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"*;

Duke qenë se vetë ATP pranon mbivendosjen e pjesshme të sipërfaqes së tokës bujqësore të njohur në pronësi të ndjerit Ibrahim Resuli me vendimin nr. 101, datë 08.02.2002, me sipërfaqen e tokës bujqësore të njohur në pronësi me të drejtë kompensimi të ndjerit Pandeli Vasil Dashi me vendimin nr. 77, datë 07.09.1999, të ish-KKKP, pranë Prefekturës së Qarkut, Fier, ATP-ja, në përputhje me **pikën 6 të Kreut III të VKM-së nr. 223/2016,** të ndryshuar, është e detyruar:

- të ekzekutojë **pjesët e vendimit që nuk janë objekt mbivendosjeje,** dhe
- të **depozitojë vlerën e pjesës me mbivendosje** në një llogari të veçantë bankare, deri në zgjidhjen përfundimtare të mosmarrëveshjes.

Më konkretisht, sipas kësaj dispozite **(pika 6 e Kreut III të VKM-së nr. 223/2016) parashikohet se:** *"Në rastet kur evidentohen mbivendosje të së drejtës për kompensim ose mosmarrëveshje gjyqësore, ATP-ja vlerëson vendimin për kompensim dhe vijon procedurat për ekzekutimin e tij në pjesët që nuk kanë mbivendosje. Për pjesën që është me mbivendosje, agjencia depoziton vlerën përkatëse në një llogari të veçantë bankare të saj e cila, pas zgjidhjes përfundimtare të mbivendosjes, i paguhet subjektit sipas marrëveshjes noteriale midis palëve ose sipas vendimit gjyqësor për zgjidhjen e mosmarrëveshjes"*.

Gjithashtu, mungesa e dokumentacionit hartografik si pjesë përbërëse e vendimit të ish-KKKP, pranë Prefekturës së Qarkut, Fier, për pasurinë e njohur në pronësi me të drejtë kompensimi, trashëgimlënësit Ibrahim Resuli, nuk përbën shkak për mosekzekutimin e vlerësimit financiar, në kuptim dhe zbatim të pikës 21/1 të VKM-së nr. 223/2016, pasi vendimi nr. 101, datë 08.02.2002, ka të përcaktuar vlerën e kompensimit financiar në dispozitiv.

Sipas kësaj dispozite (pika 21/1 e VKM-së nr. 223/2016) parashikohet se: *"Në rastet e vendimeve përfundimtare që kanë njohur të drejtën e kompensimit për pronat e përmbytura nga liqenet artificial, si dhe të vendimeve të kompensimit të përcaktuara në vlerë, të cilat i janë nënshtruar vlerësimit financiar, sipas pikës 7, të nenit 6, të ligjit nr. 133/2015, "Për trajtimin e pronave", por që u mungon harta shoqëruese e vendimit sa i takon sipërfaqes së njohur për kompensim, ATP-ja vijon procedurat e ekzekutimit të tyre në mungesë të hartës dhe të statusit*

juridik të pronës. Mënyrat e kompensimit por këto vendime do të kryhet sipas shkronjës "b", të pikës 16/6, ose sipas shkronjës "a", të pikes 16/7, të këtij vendimi. Në rastet kur subjektet që disponojnë një vendim kompensimi të vlerë pa hartë shoqëruese dhe të vlerësuar financiarisht, sipas pikës 7, të nenit 6, të ligjit nr. 133/2015, "Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave", kërkojnë të aplikojnë sipas shkronjës "a", të pikës 16/6, të këtij vendimi, atëhere vendimi duhet të plotësohet me hartë nga organet gjyqësore".

Moszbatimi i këtij detyrimi dhe ndalimi i plotë i ekzekutimit përbën **shkelje të procedurës së ekzekutimit administrativ**, duke cenuar të drejtën e ankuesit për përfitim efektiv nga vendimi përfundimtar.

Pra, ATP-ja, jo vetëm nuk ka vijuar me ekzekutimin e vendimit, por pa shkak, nuk ka marrë as vendim formal për **pezullim të procedurës, si dhe,** nuk ka dokumentuar publikimin e mangësive apo të problematikave të konstatuara në **Regjistrin Elektronik të Vendimeve** Përfundimtare, siç kërkohet nga **pika 11 e Kreut II të VKM-së nr. 223/2016**[3], edhe pse me shkresën nr. 708/6 prot, datë 19.02.2025, ka njoftuar ankuesin mbi mangësitë apo problematikat e pretenduara prej saj. Ky qëndrim i ATP-së sjell **mungesë transparence procedurale.**

Në përfundim të analizës së qëndrimit të mbajtur prej ATP-së ndaj kërkesës/aplikimit nr. 708, datë 02.12.2016, arsyetojmë/konkludojmë, se:

1. **ATP nuk ka respektuar plotësisht detyrimet e saj ligjore dhe nënligjore** për ekzekutimin e vendimit përfundimtar të kompensimit nr. 101, datë 08.02.2002, të dhënë prej ish-KKKP, pranë Prefekturës së Qarkut, Fier;
2. **Mungon transparenca** në publikimin e mangësive në regjistrin elektronik për pengesat procedurale;
3. **Moszbatimi i ekzekutimit të pjesshëm** bie ndesh me VKM nr. 223/2016 dhe me parimet kushtetuese të procesit të rregullt administrativ dhe të së drejtës së pronësisë;
4. **Veprimet e ATP-së** kanë sjellë vonesa të pajustifikuara dhe rrezikojnë **cenimin e të drejtës së ankuesit** për përfitim efektiv nga vendimi përfundimtar i njohjes së pronës.

Në bazë të analizës së kryer, qëndrimi i ATP-së vlerësohet jo **në përputhje të plotë me kuadrin ligjor** për trajtimin e pronës dhe përbën **cenim të parimeve të sigurisë juridike, transparencës dhe proporcionalitetit**. Për këtë shkak, është e nevojshme marrja e masave të mënjëhershme për garantimin dhe **zbatimin efektiv të vendimit përfundimtar** si dhe respektimin e të drejtave të subjektit ankues.

Në përputhje me pikën 2, të nenit 15, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre.

Mosveprimi evident nga ana juaj në këtë çështje nuk i respekton të drejtat e ligjshme të ankuesit, por përkundrazi është bërë shkak për shkeljen e tyre.

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe nenit 21, pika b) të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999, "*Për Avokatin e Popullit*", të ndryshuar, ku parashikohet se, "*Pas përfundimit të hetimeve, Avokati i Popullit..., paraqet*

[3] Sipas kësaj dispozite parashikohet se: "*Në rastin kur konstatohen të meta nga ATP-ja, gjykata ose subjekti i lidhur me informacionin e publikuar, i cili është i nevojshëm për vlerësimin financiar të vendimeve përfundimtare të kompesimit, ATP-ja përditëson regjistrin e vendimeve me të dhënat e sakta*"

rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive".

REKOMANDOJMË

1. *Drejtoria e Kompensimit në Agjencinë e Trajtimit të Pronave, Brenda 30 ditëve nga marrja dijeni e këtij rekomandimi, të përfundojë procedurën administrative të ekzekutimit të vendimit nr. 101, datë 08.02.2002, të ish-Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Fier, në favour të shtetasit Ridvan Resuli, dhe të nxjerrë vendimin formal të arsyetuar për përfundimin e saj, duke ia komunikuar atë me shkrim ankuesit, si dhe duke dërguar kopje të vendimit pranë Avokatit të Popullit.*

2. *Drejtoria e Kompensimit në Agjencinë e Trajtimit të Pronave, brenda 30 ditëve nga marrja dijeni e këtij rekomandimi, të kryejë verifikimin dhe korrigjimin e të dhënave të pasqyruara në sistemin Web GIS në lidhje me parcelën fizike të pronës dhe t'i njoftojë me shkrim shtetasit Ridvan Resuli dhe Avokatit të Popullit korrigjimet e kryera.*

Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999, *"Për Avokatin e Popullit"*, të ndryshuar, ju lutemi të na ktheni përgjigje me shkrim brenda 30 ditëve nga marrja e këtij rekomandimi, duke njoftuar masat e marra për zbatimin e tij.

Me besim në bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONERE

Erinda MELI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT